



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr2814/20

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Nexhmi Prebreza nga fshati Besi, Komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson me prokurë Fanol Krasniqi avokat nga Prishtina; kundër të paditurës Naxhije Osmani nga fshati Besi, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Shtetet Bashkuara të Amerikës- SHBA, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës, duke vendosur sipas Propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën, jashtë seancës gjyqësore me datën 16.08.2021 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I-** Të paditurës Naxhije Osmani nga fshati Besi, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Shtetet Bashkuara të Amerikës- SHBA, tani me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Muhamet Mujaj avokat nga Prishtina, i cili ka për obligim që të paditurën t'a përfaqësoj në procedurën për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në lëndën C.nr.2814/20.

**II-**Sipas Dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**III-**Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij me prokurë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me dt. 17.06.2020, kundër të paditurës Naxhije Osmani nga fshati Besi, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Shtetet Bashkuara të Amerikës- SHBA, tani me adresë të panjohur, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me dt. 05.07.2021, në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi me prokurë e paditësit, ndërsa për të paditurën askush nuk ka prezantuar në seancë, andaj me qëllim që çështja të mos zvarritet nga ana e të paditurës, paditësi i propozoi gjykatës që të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurën Naxhije Osmani nga fshati Besi, Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Shtetet Bashkuara të Amerikës- SHBA, tani me adresë të panjohur, të cilës tani nuk i dihet adresa.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit. Andaj, gjykata vendosi që të paditurës, t' i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Muhamet Mujaj, avokat nga Prishtina, nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do ti përfaqësoj interesat e të paditurës në këtë çështje juridiko- civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

C. nr. 2814/20 dt. 16.08.2021

Gjyqtarja  
Shpresa Veselaj



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.